LIGJ
Nr. 28/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 48/2014, "PËR PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET KONTRAKTORE E TREGTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike ose nga ana e prodhuesve bujqësore kundrejt ndërmarrjeve tregtare, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe në veçanti të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. 'Veprimi juridik tregtar' është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, përfshirë dhe faturën tatimore, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare nga njëra anë dhe prodhuesve bujqësore apo autoriteteve publike nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. 'Prodhues bujqësor' është subjekti që zhvillon aktivitetin e vet në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore, pyjore dhe peshkimi, i cili në zbatim të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, është i pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor.".

Neni 3

Në nenin 4 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në titullin e nenit pas fjalëve "veprime juridike ndërmjet" shtohen fjalët "prodhuesve bujqësorë,".

2. Kudo në nenin 4 pas fjalës "kreditori" shtohen fjalët "përfshirë këtu dhe prodhuesit bujqësorë".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 55, datë 11.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.